



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

# Rregullore e Aksesit në të Dhënat Mikro

---

*Maj 2021*

## Përmbajtja

Kreu I – Dispozita të përgjithshme .....	3
Neni 1 - Objekti .....	3
Neni 2 - Qëllimi .....	3
Neni 3 - Baza ligjore e rregullores .....	3
Neni 4 - Përkufizime .....	3
Kreu II - Tipet e të dhënave mikro.....	4
Neni 5 - Public Use Files (PUF) .....	4
Neni 6 - Scientific Use Files (SUF) .....	5
Kreu III – Të drejtat e aksesimit të SUF.....	5
Neni 7 - Minimizimi i të dhënave .....	5
Neni 8 - E drejta për hyrje në të dhënat nga burimet administrative .....	5
1. Grupet e përdoruesve me të drejtë aksesimi.....	5
2. Grupet e përdoruesve pa të drejtë aksesimi.....	5
Kreu IV – Aplikimi për akses dhe aksesimi i të dhënave .....	6
Neni 9 - Aplikimi për aksesin e të dhënave mikro.....	6
Neni 10 - Vlerësimi i aplikimit dhe aprovimi .....	6
Neni 11 - Nënshkrimi kontratës .....	6
Neni 12 - Aksesimi i të dhënave .....	7
Neni 13 - Trajtimi dhe rishikimi i rezultateve.....	7
Neni 14 - Dorëzimi i rezultatit .....	7
Neni 15 - Mbyllja e projektit.....	8
Kreu V – Të tjera .....	8
Neni 16 - Sanksionet.....	8
Neni 17 - Hyrja në fuqi .....	8
Aneks 1: Forma e aplikimit për skedarët me të dhëna mikro.....	9
Aneks 2: Format raporti që përgatitet nga subject matter .....	12
Aneksi 3: Kontratë .....	13
Aneks 4: Deklaratë konfidencialiteti (për kërkuesit shkencor).....	16
Aneks 5: Format raporti që përgatitet nga GTK .....	17
Aneks 6: Lista e të dhënave mikro të disponueshme .....	18

## **Kreu I – Dispozita të përgjithshme**

### **Neni 1 - Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave organizative dhe teknike për dhënien e aksesit në të dhënat mikro për qëllime kërkimore shkencore. Aksesit në këto të dhëna është i kontrolluar në mënyrë të rreptë dhe sipas kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 17, datë 05.04.2018 “Për statistikat zyrtare”.

INSTAT, për prodhimin e statistikave zyrtare, mbledh informacion nëpërmjet vrojtimeve statistikore (cens apo kampion) dhe burimeve administrative sipas një periodiciteti të caktuar. Të dhënat mblidhen në nivel mikro (individ, familje, njësi ekonomike).

### **Neni 2 - Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë masat organizative dhe teknike për sigurinë në administrimin dhe dhënien e aksesit në të dhënat mikro për qëllime kërkimore shkencore në mbështetje të komunitetit shkencor.

### **Neni 3 - Baza ligjore e rregullores**

Rregullorja mbi të drejtën për hyrje në të dhënat mikro bazohet në aktet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare gjithashtu dhe në programin e transparencës dhe rregulloret mbi cilësinë e informacionit:

1. Aktet ligjore kombëtare:
  - 1.1. Ligji nr. 17, datë 05.04.2018 “Për statistikat zyrtare”;
  - 1.2. Vendimi i Kuvendit nr. 10/2017, datë 09/02.2017 mbi zbatimin e “Programit Kombëtar të Statistikave Zyrtare 2017-2021”;
  - 1.3. Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
  - 1.4. Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
  - 1.5. Ligji nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.
  - 1.6. Rregullat etike për përpunimin e të dhënave personale nga punonjësit e INSTAT.
2. Aktet ndërkombëtare / evropiane:
  - 2.1. [UNECE/ statistical.confidentiality](#);
  - 2.2. [Eurostat / Statistical confidentiality](#);
3. Aktet e brendshme të INSTAT:
  - Urdhër i brendshëm nr. 208/6 Prot., datë 18.02.2019 “Për ngritjen e Grupi Teknik i Konfidencialitetit (GTK), i ndryshuar;
  - Urdhër i brendshëm nr. 208/3 Prot., datë 15.02.2019 “Për ngritjen e Komitetit të Konfidencialitetit (KK), i ndryshuar;
  - [Programi i Transparencës](#)
  - [Deklarata e Cilësisë](#)

### **Neni 4 - Përkufizime**

Për qëllim të kësaj rregullore termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- “Të dhënat mikro nga vrojtimit” janë të dhëna të regjistruara në nivel të detajuar, mbi të cilat ndërtohen të dhënat e grupuara, ku çdo regjistrim përfaqëson një përgjigje (ose disa përgjigje) të pyetjeve të përfshira në një pyetësor të veçantë. Të dhënat mikro nga vrojtimit mund të përdoren vetëm për qëllime kërkimore-shkencore. Aksesimi i tyre synon hartimin e politikave të bazuara në të dhëna, uljen e kostove të kërkimit dhe shmangien e grumbullimit të të dhënave të dyfishta.
- “Informacion sensitiv” janë të dhëna që duhen mbrojtur nga aksesimi i paautorizuar për të ruajtur privatësinë dhe sigurinë e një individi apo një organizate.
- Të dhëna individuale të mbledhura nga njësitë statistikore mikro të anonimizuar “SUF (Scientific Use Files)” janë skedarë me njësi të regjistruara, të prodhuara vetëm për qëllime kërkimore shkencore nga INSTAT, sipas neni 31, pika 5, pika 7 dhe pika 8, të ligjit nr.17, datë 05.04.2018 “Për statistikatat zyrtare”.
- Të dhëna mikro publike “PUF (Public Use Files)” janë të dhëna mikro me informacion individual për personat, familjet apo ndërmarrjet. Këto skedarë janë krijuar që publiku të familjarizohet me të dhënat mikro statistikore. Skedarët janë përgatitur në mënyrë të tillë që njësitë individuale nuk mund të identifikohen.
- Aktivitet statistikor është çdo veprim i ndërmarrë për realizimin e një rezultati statistikor që mund të jetë: cens, vrojtim ose e dhënë administrative.
- Eksperti i fushës Subject matter është eksperti i statistikës në fjalë që menaxhon aktivitetin statistikor për të cilin është bërë kërkesa për të dhëna mikro.
- Në ambientet e INSTAT “Onsite” ndodhet “Dhoma e sigurtë në të cilën gjenden kompjutera të dedikuar për aksesimin e të dhënave mikro.
- SIMONA është një sistem që përdoret për aksesimin online remote të të dhënave mikro nga kërkuesit shkencorë.

## Kreu II – Tipet e të dhënave mikro

### Neni 5 - Public Use Files (PUF)

INSTAT ofron akses për përdoruesin e gjerë në skedarët mikro të anonimizuar në Public Use Files (PUF). Këto skedarë përmbajnë të dhëna mikro që janë prodhuar për qëllime statistikore/kërkimore në një formë të tillë që informacioni sensitiv për një njësi apo individ nuk është i identifikueshëm në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë. Këto skedarë mund të aksesohen në [faqen e INSTAT](#).

Të dhënat mikro që janë publike në faqen e INSTAT janë:

- Anketa e Forcave të Punës 2007-2013;
- Anketa e Përdorimit të Kohës 2010-2011;
- Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës 2002, 2005, 2008, 2012;
- Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011;
- Të dhënat mikro të anketës së Migracionit të kthimit dhe ri-integrimit në Shqipëri 2013.

## **Neni 6 - Scientific Use Files (SUF)**

Scientific Use Files (SUF) janë skedarë me të dhëna në nivel njësie statistikore, të cilat nuk përmbajnë identifikues të drejtëpërdrejtë, por mund të mbajnë riskun për t'u identifikuar në mënyrë të tërthortë. SUF nuk janë produkte statistikore të publikueshme, ato përdoren vetëm për qëllime kërkimore-shkencore.

## **Kreu III – Të drejtat e aksesimit të SUF**

E drejta e hyrjes në të dhënat mikro për projekte kërkimore-shkencore mund të jepet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it për një periudhë të kufizuar, duke siguruar se të dhënat nuk lejojnë identifikimin e drejtëpërdrejtë. E drejta e hyrjes në këto të dhëna jepet pasi pasi të dhënat janë publikuar nga INSTAT. Për të mundësuar të drejtën e aksesit në SUF, çdo kërkues shkencor (punonjës apo jo i INSTAT-it, apo i një agjencie statistikore), institucioni ose organizate, duhet të zbatojë këtë rregullore dhe anekset (1-3) pjesë përbërëse të saj.

## **Neni 7 - Minimizimi i të dhënave**

Në rastet kur është e realizueshme, kërkesat për të dhëna do të përmbushen nëpërmjet sigurimit të të dhënave të grupuara (ose në skedarë të anonimizuar). Kjo për të minimizuar të drejtën e hyrjes tek të dhënat mikro, duke respektuar qëllimin e kërkimit. Kjo do të thotë që, informacioni i dhënë kërkuesit shkencor do të jetë i kufizuar në ato ndryshore (variabla) të cilat janë të nevojshme për kërkimin specifik statistikor. Është rreptësisht e ndaluar dhënia e identifikuesve të drejtëpërdrejtë, qoftë edhe për kërkime shkencore.

## **Neni 8 - E drejta për hyrje në të dhënat nga burimet administrative**

E drejta për hyrje në të dhënat nga burimet administrative do të jetë e kufizuar. Aksesit do të jetë vetëm në të dhëna për një kampion të caktuar, në masën 3% dhe mund të jetë subjekt i kushteve shtesë të kontratës të përcaktuar nga INSTAT.

### **1. Grupet e përdoruesve me të drejtë aksesit**

- a. Kërkuesit shkencor të cilët, ose në të drejtën e tyre ose si punonjës të një organizate/institucioni kërkimor të njohur që ka një evidencë të provuar në analizën e të dhënave ose në kërkim shkencor.
- b. Kërkuesit ose individët që punojnë në organizata/institucione që mund të japin një arsye specifike të kërkimit, i cili duhet t'i shërbejë drejtëpërdrejt qëllimit të përmirësimit ose të prodhimit të produkteve statistikore zyrtare.
- c. Studentët e nivelit Ph.D ose më lart, për të cilët duhet marrë konfirmimi nga pedagogu udhëheqës dhe një vërtetim nga institucioni arsimor që studenti vazhdon studimet në nivelet e sipërpërmendura.

### **2. Grupet e përdoruesve pa të drejtë aksesit**

- a. Individët të cilët nuk janë pjesë e një organizate/institucioni sipas shkronjës (a) dhe (b) të pikës 1 të këtij neni ;

- b. Individët të cilët punojnë për një ndërmarrje ose janë pjesë e një ndërmarrje, e cila gjendet në skedarin e të dhënave mikro të ndërmarrjeve;
- c. Media dhe organizata ose institucione të lidhura me to.

## **Kreu IV – Aplikimi për akses dhe aksesimi i të dhënave**

### **Neni 9 - Aplikimi për aksesin e të dhënave mikro**

Kërkesa për të marrë të drejtën për hyrje në SUF bëhet duke plotësuar Formularin e aplikimit ([Aneks 1](#)) i cili firmoset dhe dërgohet në origjinal pranë INSTAT në adresën: Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri ose dërgohet në adresën e email-it: [info@instat.gov.al](mailto:info@instat.gov.al) i firmosur elektronikisht së bashku me kopjen e mjetit të identifikimit.

### **Neni 10 - Vlerësimi i aplikimit dhe aprovimi**

1. INSTAT merr në konsideratë vetëm ata formularë të cilët janë të plotësuar në rregull konform kërkesave. Vlerësimi i aplikimit paraprakisht bëhet nga Sektori i Marrëdhënieve me Publikun nëse aplikuesi është pjesë e grupit të përdoruesve që u lejohet aksesin në të dhënat mikro.
2. Pas aprovimit të formularit të aplikimit nga Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, formulari i kalon subject matter-it nën përgjegjësinë e të cilit janë të dhënat mikro që kërkohen.
3. Subject matter me marrjen e formularit të aplikimit përgatit raportin përmbledhës për KK pas marrjes së aprovimit nga eprori direkt dhe drejtori i drejtorisë së përgjithshme. (Modeli i raportit përmbledhës sipas [Aneksit 2](#)).
4. E drejta e hyrjes në të dhënat mikro jepet vetëm nga Drejtori Përgjithshëm pas aprovimit të Komitetit të Konfidencialitetit.
5. Periudha e vlerësimit të aplikimit mund të zgjasë deri në një muaj nga data e marrjes së formularit të aplikimit.

### **Neni 11- Nënshkrimi kontratës**

11.1 Kërkuesi shkencor para fillimit të punës me të dhënat mikro duhet të nënshkruajë një kontratë me INSTAT-in sipas modelit në [Aneksin 3](#). Gjithashtu, kërkuesi duhet të dorëzojë Deklaratën e konfidencialitetit të firmosur sipas modelit në [Aneks 4](#) dhe vërtetimin si punonjës i një organizate/institucioni kërkimor ose vërtetim nga institucioni arsimor ku vazhdon studimet në nivelet Ph.D ose më lart.

11.2 Dokumentat origjinale të kërkuar më sipër duhet të depozitohen fizikisht pranë INSTAT.

## **Neni 12 - Aksesimi i të dhënave**

Pas nënshkrimit nga palët të dokumenteve të përcaktuara në nenet 9 dhe 11 të kësaj rregullore, (Forma e Aplikimit, Kontrata dhe Deklarata e Konfidencialitetit), skedari i krijuar me të dhëna mikro vihet në dispozicion të kërkuesit shkencor në zyrat e INSTAT ose nëpërmjet një sistemi remote. Të dhënave gjithashtu i bashkëngjiten metadatat përshkruese aty ku është e mundur.

Ka dy mënyra për aksesimin e të dhënave:

### **1. On-site:**

- SUF mund të aksesohen në dhomën e sigurtë në INSTAT të ndërtuar për këtë qëllim. Në kompjuterat e vendosur aty, janë të instaluar SPSS, SAS dhe R për përpunimin e të dhënave.
- Në rastin e aksesimit në dhomën e sigurt, kërkuesve do u vihet në dispozicion dokumenti me udhëzime për përdorimin e “Dhomës së sigurtë”. INSTAT rezervon të drejtën për të kontrolluar kërkuesin shkencor gjatë punës në dhomën e sigurt pranë INSTAT, pa njoftim paraprak, për të siguruar që janë zbatuar procedurat e duhura për të mbrojtur konfidencialitetin e të dhënave.
- Regjistrimi, kopjimi ose përpjekja për të transferuar të dhëna në çdo format nga kompjuteri i caktuar për këtë qëllim është rreptësisht i ndaluar.

### **2. Statistical Microdata Online Access (SIMONA):**

- Përdoruesit e SIMONA-s punojnë në mjedis Windows nëpërmjet lidhjes remote. Të dhënat mikro që bëhen të disponueshme mund të procesohen duke përdorur software falas si R, PSPP, Libre Office, BlueSky, Wordpad dhe QGIS.
- Kërkuesve u vihet në dispozicion një manual për hyrjen dhe përdorimin e sistemit.
- Regjistrimi, kopjimi ose transferimi në kompjuterat personale nuk është i mundur. Të dhënat procesohen në sistemin SIMONA dhe vetëm rezultatet e grupuara dërgohen me email nga INSTAT sipas parashikimeve të nenit 14.

## **Neni 13 - Trajtimi dhe rishikimi i rezultateve**

Rezultatet (raporte, publikime, prezantime, artikuj, etj.) kontrollohen nga subject matter dhe nga GTK. GTK së bashku me subject matter përgatisin një relacion shpjegues për Drejtorin e Përgjithshëm (sipas modelit në [Aneksin 5](#)). Nëse këto rezultate nuk janë të krahasueshme me statistikat zyrtare të publikuara ose kanë zbulim informacioni konfidencial, ato nuk i vihen në dispozicion kërkuesit. Në këto raste, kërkuesi mund të rrisë nivelin e agregimit deri në pikënjë nuk ka më zbulim të të dhënave sensitive dhe konfidenciale.

## **Neni 14 - Dorëzimi i rezultatit**

Rezultatet e aprovuara nga Drejtori i Përgjithshëm i dërgohen me e-mail kërkuesit shkencor nga Sektori i Marrëdhënieve me Publikun.

### **Neni 15 - Mbyllja e projektit**

1. Pas përfundimit të afatit (të specifikuar në Formën e aplikimit dhe në Kontratë) për aksesimin e të dhënave, kërkuesi nuk mund ti aksesojë më ato. Kjo realizohet duke çaktivizuar përdoruesin në SIMONA ose duke mos lejuar hyrjen on-site.
2. Të dhënat e përpunuara dhe sintaksa e përdorur, ruhen në servera të dedikuar në INSTAT.
3. INSTAT duhet të pranohet si burim i të dhënave në të gjitha rezultatet, duke përfshirë citimin në tabelat dhe analizat e grupuara bazuar në treguesit e nxjerrë. Citimi vijues duhet të përfshihet në të gjitha botimet: *“Rezultatet bazohen në analizën e të dhënave mikro të kontrolluara rreptësisht nga INSTAT. INSTAT nuk merr asnjë përgjegjësi për pikëpamjet e shprehura apo rezultatet e krijuara nga ky kërkim”*.
4. Të dhënat mikro, pavarësisht ndonjë ndryshimi që mund ti ketë bërë kërkuesi gjatë analizës, mbeten pronë e INSTAT pas marrjes së miratimit të kërkuesit shkencor.

### **Kreu V – Të tjera**

#### **Neni 16 - Sanksionet**

1. Mosrespektimi i dispozitave të kësaj rregullore termave dhe kushteve të përcaktuara në kontratën e nënshkruar mund të ketë implikime për individin dhe organizatën / institutin për të cilin ata punojnë.
2. Këto sanksione mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:
  - a) Kërkesa për kthim dhe/ose ndërprerjen e hyrjes tek të gjitha informacionet e ofruara nga INSTAT, në rastin e mosrespektimit të kriterëve dhe kushteve të kontratës për të drejtë hyrje në të dhënat mikro apo Deklaratës së konfidencialitetit;
  - b) Refuzimi i kërkesave të ardhshme për të drejtë hyrje tek të dhënat mikro.
3. Në të gjitha rastet, si refuzim apo aprovim, aplikuesi lajmërohet me e-mail.

#### **Neni 17 - Hyrja në fuqi**

Rregullorja “E drejta për hyrje në të dhënat mikro” nr. \_ datë \_\_\_\_\_ shfuqizohet. Kjo rregullore hyn në fuqi me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm pas marrjes së mendimit nga Komiteti Teknik i Konfidencialitetit.



## Aneks 1: Forma e aplikimit për skedarët me të dhëna mikro

### **Kreu 1: Organizata/institucioni kërkimor**

Emri:	Adresa:	Qyteti:
-------	---------	---------

#### **Përfaqësues i Organizatës/institucionit kërkimor:**

Titulli:	Emri:	Mbiemri:
Pozicioni:	Adresa e-mail:	Numri i telefonit:

### **Kreu 2: Përdoruesit e të dhënave**

#### **Ju lutem identifikoni të gjithë personat të cilët do të punojnë me të dhënat.**

Titulli:	Emri Mbimeri:	Numri i Identifikimit:
Institucioni (universiteti, institucioni):	Adresa e institucionit:	Pozicioni:
Adresa e-mail:	Numri i telefonit:	Person kontakti: <input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo

Titulli:	Emri Mbimeri:	Numri i Identifikimit:
Institucioni (universiteti, institucioni):	Adresa e institucionit:	Pozicioni:
Adresa e-mail:	Numri i telefonit:	Person kontakti: <input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo

Titulli:	Emri Mbimeri:	Numri i Identifikimit:
Institucioni (universiteti, institucioni):	Adresa e institucionit:	Pozicioni:
Adresa e-mail:	Numri i telefonit:	Person kontakti: <input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo

**Nëse ju po aplikoni për qëllime studimore (në nivelin arsimor Ph.D ose më lart), ju lutem identifikoni pedagogun udhëheqës, si dhe duhet ti bashkëngjisni kësaj forme aplikimi dhe vërtetimin që jeni student në nivelin Ph.D ose më lart nga Institucioni arsimor.**

Tema:	Adresa e-mail e pedagogut udhëheqës:	Numri i telefonit i pedagogut udhëheqës:	Firma e pedagogut udhëheqës
-------	--------------------------------------	--	-----------------------------

### Kreu 3: Përshkrimi i projektit

1. Titulli i projektit:	
2. Fokusi i projektit (Mund të zgjidhni më shumë se një alternative): <input type="checkbox"/> Tezë Ph.D ose nivel më i lartë studimi <input type="checkbox"/> Projekt kërkimi Tjetër fokus projekti:	
3. Çfarë do të studiohet në këtë projekt:	
4. Keni kryer studime ose projekte të ngjashme me këtë temë më parë?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
4.1 Nëse po, përshkruani:	
5. Pse është i nevojshëm aksesimi në të dhënat mikro për këtë projekt? (Shpjegoni pse nuk mund të përdoren të dhënat e grupuara)	
6. A ka ndonjë burim tjetër të dhënash për projektin e propozuar?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
6.1 Nëse po, pse po kërkoni të dhëna mikro?	
7. Cila nga njësitë e mëposhtme nevojitet për projektin: <input type="checkbox"/> Individë <input type="checkbox"/> Familje <input type="checkbox"/> Ndërmarrje <input type="checkbox"/> Tjetër:	
8. Tregoni nivelin më të ulët gjeografik në të cilin do të jepen rezultatet e projektit: <input type="checkbox"/> Kombëtar <input type="checkbox"/> Prefekturë <input type="checkbox"/> Bashkie <input type="checkbox"/> Tjetër:	
9. Cilat metoda statistikore do të përdoren:	
10. Specifikoni gjatësinë e kohës për të cilën ju kërkoni të keni të drejtë hyrje në të dhënat mikro Nga (muaji/viti): Deri (muaji/viti):	
11. Listoni detaje të rezultatit/rezultateve (si p.sh. raporte, artikuj, libra, etj.) dhe auditorin e synuar për rezultatet e propozuara Rezultatet Auditori i synuar:	

### Kreu 4: Të dhënat e kërkuesit (lista e të dhënave që mund të vihen në dispozicion janë në Aneksin 6 në Rregulloren Aksesi në të Dhënat Mikro)

- Aplikimi është i vlefshëm për një aktivitet statistikor

<i>Të dhëna mikro</i>	<i>Periudha referencë</i>

Ku dëshironi të aksesoni të dhënat? <input type="checkbox"/> Në dhomën e sigurtë në INSTAT <input type="checkbox"/> SIMONA	
Software i preferuar për analizimin e të dhënave në dhomën e sigurtë: <input type="checkbox"/> SPSS <input type="checkbox"/> SAS <input type="checkbox"/> R <input type="checkbox"/> Tjetër:	
Informacion shtesë në lidhje me software e përzgjedhur (p.sh. versioni):	

### **Kreu 5: Shënime/komente shtesë**

### **Kreu 6: Klauzola Deklarative**

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe në respektim të ligjit Nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, autorizoj me vullnetim tim të lirë institucionin, të përpunojë dhe të përdorë të dhënat e mia personale, për qëllime statistikore dhe të shqyrtimit të aplikimit.

### **Kreu 7: Nënshkrimi i aplikantit**

Nënshkrimi:

Data:

Nënshkrimi:

Data:

Nënshkrimi:

Data:

**Aneks 2: Format raporti që përgatitet nga subject matter**

*Raport përmbledhës për miratimin e aksesimit të të dhënave mikro*

Tiranë, më \_\_\_\_\_

Miratohet \_\_\_\_\_

**Për:           Komitetin e Konfidencialitetit**

**Subjekti:    Aksesimi i të dhënave mikro**

Mbështetur në formën e aplikimit me Nr. Prot \_\_\_\_\_ për aksesimin e të dhënave mikro të skedarit të \_\_\_\_\_ me periudhë reference \_\_\_\_\_ të kërkuara nga kërkuesi/t shkencor \_\_\_\_\_ në kuadër të projektit \_\_\_\_\_, gjykoj që përdoruesit ti jepet/mos ti jepet e drejta për aksesim.

Gjykimi arsyetohet si më poshtë:

Specialist Sektori \_\_\_\_\_

Përgjegjës Sektori \_\_\_\_\_

Konfirmoi: *Eprori direkt* \_\_\_\_\_

Konfirmoi: *Drejtori i drejtorisë së përgjithshme të eprorit direkt* \_\_\_\_\_

### **Aneksi 3: Kontratë**

Kjo Kontratë hartohet sot më datë \_\_\_\_\_ në Tiranë

ndërmjet palëve

- **Instituti i Statistikave** me adresë në Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri  
në vijim referuar si “INSTAT”

dhe

- \_\_\_\_\_ në vijim referuar si “Kërkuesi shkencor”

#### **1. Baza ligjore:**

Hartimi i kësaj kontrate mbështetet në Ligjin nr. 17 datë 5.04.2018 për “Statistikat Zyrtare” dhe Ligjin nr. 9987 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

#### **2. Qëllimi**

Qëllimi i kësaj kontrate është vënia në dispozicion e të dhënave sipas Shtojca 1 i kësaj kontrate që është dhe pjesë përbërëse e saj bazuar në kërkesën e aprovuar nr. \_\_\_\_\_ Prot. datë \_\_\_\_\_ në kuadër të projektit kërkimor \_\_\_\_\_

#### **3. Afati:**

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë \_\_\_\_\_ nga momenti i firmosjes së saj nga të dyja palët.

#### **4. Detyrat dhe Përgjegjësitë e palëve:**

4.1. Për INSTAT:

Për të realizuar objektin e kësaj kontrate INSTAT merr përsipër:

- i) të vërë në dispozicion të kërkuesit shkencor të dhënat \_\_\_\_\_.
- ii) të krijojë kushte teknike për aksesin në të dhëna.
- iii) të ofrojë aksesin në të dhëna vetëm nëpërmjet kompjuterave të INSTAT në dhomën e sigurt ose në sistemin SIMONA.

Përfaqësues i INSTAT për ndjekjen e zbatimit të kësaj kontrate caktohet: Z/Znj. \_\_\_\_\_, me adresë email-i: \_\_\_\_\_

4.2. Për Kërkuesin shkencor

Për të realizuar objektin e kësaj kontrate \_\_\_\_\_ merr përsipër:

- a. të përdorë të dhënat vetëm për realizimin e projektit kërkimor shkencor \_\_\_\_\_.
- b. të sigurojë që rezultati i parashikuar nuk u referohet njërive të identifikueshme ose nuk lejon identifikimin e tërthortë;
- c. të sigurojë standardin e mbrojtjes së të dhënave konfidenciale, brenda projektit të kërkimit;
- d. të zhdukë menjëherë të dhënat, sapo projekti përfundon, duke njoftuar me shkrim INSTAT-in për këtë veprim brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të kësaj kontrate.

#### **5. Konfidencialiteti**

INSTAT dhe kërkuesi shkencor duhet të trajtojnë si konfidenciale të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën në përputhje me Ligji nr. 17, datë 5.04.2018 “Për statistikat zyrtare”, Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

## **6. Transferimi i të Drejtës për akses në të dhëna mikro**

Kërkuesi shkencor nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim të rastit kur jepet miratimi paraprak i INSTAT.

## **7. Ndërprerja për Mosplotësim**

7.1 INSTAT mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse Kërkuesi shkencor dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

7.2 INSTAT duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kërkuesit shkencor 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

## **8. Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

8.1 INSTAT mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

8.2 INSTAT duhet t'i japi Kërkuesit shkencor lajmërim me shkrim për ndërprerjen 15 ditë përpara vendimit për ndërprerjen e kontratës.

## **9. Forca Madhore**

Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kërkuesit shkencor mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e INSTAT qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës ose të gjitha rrethanat që rrezikojnë jetën ose kushtet normale të jetesës së të gjithë popullsisë ose të një pjese të saj.

Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, palët duhet të njoftojë menjëherë njëra tjetrën. Me përjashtim kur INSTAT jep direktiva të ndryshme, Kërkuesi shkencor duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

## **10. Sanksionet**

Mosrespektimi i termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë kontratë përbën kundërvajtje administrative e cila përfshin por nuk kufizohet vetëm në: dënimin me gjobë sipas përcaktimeve të ligjit për statistika zyrtare, neni 38 "Kundërvajtjet administrative dhe gjobat" shkronja b) por dhe në:

1. Kërkesa për kthim dhe/ose ndërprerjen e hyrjes tek të gjitha informacionet e ofruara nga INSTAT, në rastin e mosrespektimit të kriterëve dhe kushteve të marrëveshjes për të drejtë hyrje në të dhënat mikro, apo deklaratës së konfidencialitetit;
2. Refuzim i kërkesave të ardhshme për të drejtë hyrje tek të dhënat mikro.

## **11. Negociatat dhe Amendamentet**

11.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e saj.

11.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga palët.

## **12. Të tjera**

- 12.1. Për gjithçka që nuk parashikohet në këtë kontratë, vlejné parashikimet e legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 12.2. Për mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, palët i drejtohen për zgjidhje Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
- 12.3. Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.
- 12.4. Kjo marrëveshje hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë.

Për:

---

Data e nënshkrimit:

---

Për:

- Institutin e Statistikave, INSTAT

- Drejtor i Përgjithshëm

Data e nënshkrimit:

---

#### **Aneks 4: Deklaratë konfidencialiteti (për kërkuesit shkencor)**

Unë i/e nënshkruari/a, në cilësinë e \_\_\_\_\_ nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se pranoj të marr përsipër të mos përdor dhe të mos u transmetoj personave të paautorizuar të dhënat e skedarit të kërkuar me emër \_\_\_\_\_ apo informacione konfidenciale në lidhje me ose të marra nga INSTAT, në kuadër të projektit të kërkimit me titull \_\_\_\_\_, përveç rastit kur autorizohem shprehimisht nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it.

1. Duke nënshkruar këtë deklaratë, deklaroj se jam në dijeni se përdorimi dhe zbulimi i të dhënave trajtohet nga Ligji nr. 17, datë 5.4.2018 “Për statistikën zyrtare” dhe Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Unë nuk do të përdor ose përhap asnjë të dhënë që marr dijeni gjatë punës time për ndonjë qëllim që është në kundërshtim me qëllimet e kësaj pune.

2. Unë deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë, se jam i detyruar të ruaj konfidencialitetin për të dhënat personale dhe t’i mbaj ato të sigurta, duke marrë të gjitha masat organizative dhe teknike të përshtatshme. Unë e kuptoj se ky detyrim vlen si gjatë afatit të projektit të kërkimit, ashtu dhe pas përfundimit të tij.

3. Unë marr përsipër përgjegjësinë e plotë që në qoftë se, konstatohet se kam vepruar në kundërshtim me udhëzimet në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave apo në rast të mosruajtjes së tyre, ndaj meje të merren masa të menjëhershme sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Unë e kuptoj këtë veprim si një nevojë për të ruajtur imazhin e institucionit dhe respektuar të drejtat themelore të individëve, për sa i takon parimit të mbrojtjes së të dhënave konfidenciale.

4. Unë e kuptoj se kam detyrim të zhduk menjëherë çdo informacion apo të dhënë personale për të cilat jam vënë në dijeni sapo projekti përfundon, duke njoftuar me shkrim INSTAT-in për këtë veprim.

5. Unë e kuptoj se moszbatimi ose shkelja e kërkesave të konfidencialitetit, të përcaktuara në nenin 31 të Ligjit Nr. 17, datë 5.4.2018 për “Statistikën Zyrtare”, përbën kundërvajtje administrative sipas përcaktimit të nenit 38, shkronja b) dhe dënohet me gjobë nga 20 000 lekë deri në 30 000 lekë.

*Për:* \_\_\_\_\_

*Emër Mbiemër:* \_\_\_\_\_

*Nënshkrimi:* \_\_\_\_\_

*Pozicioni:* \_\_\_\_\_



## **Aneks 5: Format raporti që përgatitet nga GTK**

### **Raport për miratimin e dërgimit të rezultateve**

**Tiranë, më** \_\_\_\_\_

**Miratohet** \_\_\_\_\_

**Për: Drejtorin e Përgjithshëm**

**Subjekti: Aksesimi i të dhënave mikro**

Mbështetur në formën e aplikimit me Nr. Prot \_\_\_\_\_ për aksesimin e të dhënave mikro të skedarit të \_\_\_\_\_ me periudhë reference \_\_\_\_\_ të kërkuara nga kërkuesi/t shkencor \_\_\_\_\_ në kuadër të projektit \_\_\_\_\_, gjykohet që përdoruesit ti jepen/mos ti jepen rezultatet e punimit.

Gjykimi arsyetohet si më poshtë:

Konfirmoi: \_\_\_\_\_

*Subject matter*

Konfirmoi: \_\_\_\_\_

*Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Bazave të të Dhënave dhe Aksesit në*

*Mikrodata*

Konfirmoi: \_\_\_\_\_

*Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve Ligjore/Administrative*

Konfirmoi: \_\_\_\_\_

*Përgjegjës i Sektorit të Llogarive të Sektorëve Institucionalë*

Konfirmoi: \_\_\_\_\_

*Përgjegjës i Sektorit të Çmimeve*

Konfirmoi: \_\_\_\_\_

*Përgjegjës i Sektorit të Statistikave të Blegtorisë dhe Peshkimit*

Konfirmoi: \_\_\_\_\_

*Përgjegjës i Sektorit të Statistikave Strukturore*

Konfirmoi: \_\_\_\_\_

*Përgjegjës i Sektorit të Statistikave të Konsumit të Familjeve*

Konfirmoi: \_\_\_\_\_

*Specialist në Sektorin e Metodologjisë*

## **Aneks 6: Lista e të dhënave mikro të disponueshme**